

Presidenti Rexhep Tajip Erdoan në fjalën që mbajti dje në Samitin e Udhëheqsve Fetarë Myslimanë të Vendeve të Amerikës Latine tha se ata që e ngrejne botën në këmbë për Kobanin nuk shqetësohen aspak kur bëhet fjalë për Halepin.

“Planet po bëhen tinzërisht dhe mbi këto planet duhet qëndruar”, theksoi Erdoan.

“Ajo që na takon neve deri në frymën e fundit është të flasim dhe shpjegojmë Krijuesin si dhe t'i ftojme njerëzit në rrugën e Krijuesit”, cilësoi ai.

“Me institucionet tona kombëtare dhe me ato ndërkombëtare ku jemi pjesëmarrës punojmë për të hedhur në çdo vend themelet e paqes, miqësisë, vëllazërisë dhe solidaritetit. Me institucionet tona siç janë TIKA, Gjysmëhëna e Kuqe, AFAD, Institutet Junus Emre, TRT, Agjencia Anadolli e lajmeve, Departamenti i Bashkëatdhetarëve dhe Komuniteteve Farefisnore po bëjmë përpjekje për të qenë pranë të shtypurve, të pafajshmeve, të skamureve, miqve dhe vëllezërve tanë”, tha Presidenti Rexhep Tajip Erdpoan.

“Shikoni gjendjen e kompleksit Al-Aksa... Çfarë do të bënte bota në qoftë se një diçka e tillë do të kishte ndodhur në vendet tona kundër faltoreve të tyre? A e ka ngritur njeri zërin për ato që kanë ndodhur në Ak-Aksa? Çfarë do të bënte bota nëse një gjë e tillë do të kishte ndodhur kundër kishave? Por siç e shikoni, ne nuk lejojmë kurrën e kurrës që të ndodhë ndonjë veprim i tillë në vendete tona. Cila është arsyeja? Sepse në fenë tonë nuk bëhet fjalë për një sulm të tillë, për një shkatërrim e rrënim të tillë. Xhamia Al-Aksa nuk u takon vetëm palestinezëve. Ajo është një nga dy kiblet e myslimanëve në mbarë botën. Si rrjedhim kemi të bëjmë me një detyrë, përgjegjësi që na takon të gjithëve. Por shikoni edhe një botën, a po e ngreh zërin ajo përballë gjithë këtyre veprimeve?, vijoi Erdoan.

Cili është ai që mund të thotë se ata që e përdorin fenë e paqes, Islamin, për të emërtuar organizatat e tyre të pista terroriste, rrjetet e tyre kriminale, se po i shërbejnë islamit, se janë në rrugën e Kur'anit dhe Sunetit? Kush mund të pretendojë që ata që kanë tradhtuar atdheun e tyre dhe myslimanët për llogari të vendeve dhe vatrave të tjera janë duke e respektuar Islamin, se janë vullnetarë për t'i shërbyer Islamit?, tha Erdoan./trt/